

KRU. "GJAKOVA" SHA. Gjakovë			
Marrë në datën: <u>29.04.2021</u>			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	<u>743</u>		



Republika e Kosovës	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtori për Punë të Përgjithshme Administrative	
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove	
KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë	
Nr./Br.	<u>413/01-11501</u>
Data/Datum	<u>11.05.2021</u>
Gjakovë-Djakovica-Gjakova	



Komuna Gjakovë

MARRËVESHJE

PËR BASHKËFINANCIM NË REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË LAGJEN E FIRZËS PËR 42 SHTËPI, L = 8268 m" NË KOMUNËN E GJAKOVËS

E lidhur me datën 11.05.2021 në mes të palëve

KRU. "Gjakova" Sh.A. - Gjakovë, të cilën e përfaqëson, Kryeshefi Ekzekutiv z. Ismet Ahmeti, Ofruesi i Shërbimeve të ujit të pijes.

Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini

Vendosen

Të lidhin këtë marrëveshje me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i palëve në Marrëveshje në realizimin e projektit "Ndërtimi i Ujësjiellësit në lagjen e Firzës për 42 shtëpi, L = 8268 m", në Komunën e Gjakovës.

Neni 2

Obligimet e palëve në marrëveshje

2.1. Palët në marrëveshje, Komuna e Gjakovës dhe KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, u dakorduan që të bashkë financojnë në realizimin e projektit "Ndërtimi i Ujësjiellësit në lagjen e Firzës për 42 shtëpi, L = 8268 m", që do të realizohen në Komunën e Gjakovës

2.2. Kostoja totale e projektit sipas para masës dhe parallogarisë përfshinë vlerën **50,000.00 €**.

2.3. Në realizimin e projektit si në paragrafin 2.2, të këtij neni, pala në Marrëveshje, u dakorduan që Komuna e Gjakovës nga buxheti i saj do të participoj me 49% të vlerës së kontraktuar (të kontratës), ndërsa K.R.U. "Gjakova" SH.A. me 51% sipas të vlerës së kontraktuar (të kontratës).

Neni 3

Procedura e Prokurimit

3.1. Procedurën e prokurimit në realizimin e projektit si në neni 1, paragrafin 1.1, të kësaj marrëveshje, për zgjedhjen e operatorit-kryesit të punimeve, do të zhvillohet nga KRU “Gjakova” Sh.A.

3.2. Komisionet për pranimin teknik të projektit si në paragrafin 1.1 me bashkëfinancim, do të kenë përbërje (dy anëtar nga KRU “Gjakova” dhe një anëtar nga Komuna e Gjakovës), në përputhje me Ligjin e Prokurimit.

Neni 4

Rregullat tjera

4.1. Në vitet në vijim palët në marrëveshje u pajtuan që ti koordinojnë aktivitetet e parapara për investime, në mënyrë që të planifikohen paraprakisht investimet në sferën e realizimit të ndërtimit të rrjetave të reja të ujësjellësit dhe kanalizimeve si dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese.

4.2. Investimi i përbashkët i këtij projekti me bashkëfinancim, palët u dakorduan që të jenë në pronësi të KRU “Gjakova” Sh.A. si ofrues i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

4.3. Kësaj Marrëveshje i bashkëngjitet paramasa dhe parallogaria e projektit: “Ndërtimi i Ujësllësit në lagjen e Firzës për 42 shtëpi, L = 8268 m”.

Neni 5

Mosmarrëveshjet

5.1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje, pajtohen që mos marrëveshjet të zgjidhet me mirëkuptim dhe në frymën e marrëdhënieve të mira.

5.2. Çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë marrëveshje duhet të rregullohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe aktet tjera ligjore.

Neni 6

Hyrja në Fuqi e Marrëveshjes

6.1. Kjo marrëveshje është lëshuar në dy kopje origjinale, ku secila nga palët do të mbaj nga një kopje.

6.2. Kjo marrëveshje, hynë në fuqi dhe duhet të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

PALËT KONTRAKTUESE

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"GJAKOVA" Sh.A.-Gjakovë
Kryeshefi Ekzekutiv


Ismet Ahmeti



Komuna e Gjakovës
Kryetar i Komunës


Ardian Gjini

